

DOKUMENTI KONSULTATIV

Për projektligjin “Për Kinematografinë dhe Audiovizualin”

Projektligji “Për kinematografinë dhe audiovizualin” synon të modernizojë kuadrin ligjor të industrisë filmike dhe audiovizuale në Shqipëri, duke zëvendësuar ligjin ekzistues të vitit 1996, i cili nuk i përgjigjet më zhvillimeve teknologjike dhe ekonomike të sektorit. Ai zgjeron fushën e rregullimit përtej prodhimit filmik tradicional, duke përfshirë platformat digjitale, prodhimet televizive, videolojërat dhe formatet e reja audiovizuale, në përputhje me standardet europiane. Një nga risitë kryesore të projektligjit është krijimi i mekanizmave modernë të financimit dhe nxitjes ekonomike, veçanërisht skema “cash rebate”, që parashikon rimbursim deri në 35% të shpenzimeve të kualifikuara të prodhimit në Shqipëri. Përmes këtyre instrumenteve, synohet të tërhiqen investime vendase dhe të huaja, të rritet konkurrueshmëria e industrisë dhe të zhvillohet më tej sektori audiovizual në vend.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimet në portalin e Regjistrimit Elektronik: 20 ditë pune, duke filluar nga data 12 Maj 2026 deri në datë 09 Qershor 2026.

Si të përgjigjeni:

Kontributet që në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, do të përcillen nga institucionet e interesuara me anë të regjistrimit elektronik në adresën <http://www.konsultimipublik.gov.al>.

Kontakti:

Eliverta Vraniçi

Eliverta.Vranici@mtks.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

E-Konsultimi: në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” 20 ditë pune, duke filluar nga data 09 Qershor 2026.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektligji “Për Kinematografinë dhe Audiovizualin” propozohet si përgjigje ndaj nevojës për modernizimin e kuadrit ligjor që rregullon industrinë filmike dhe audiovizuale në Republikën e Shqipërisë. Ligji aktual për kinematografinë nuk i përgjigjet zhvillimeve bashkëkohore teknologjike, ekonomike dhe tregtare, veçanërisht në raport me platformat digjitale, bashkëprodhimet ndërkombëtare dhe instrumentet moderne të financimit. Projektligji synon krijimin e një kuadri të ri institucional dhe financiar, përmes ngritjes së AKKA-së, skemave të incentivave fiskale dhe mekanizmave të mbështetjes për sektorin

audiovizual. Nëpërmjet kësaj reforme synohet rritja e konkurrueshmërisë së Shqipërisë, tërheqja e investimeve, zhvillimi i industrive kreative dhe promovimi ndërkombëtar i kulturës dhe territorit shqiptar.

Propozimet

Miratimi i këtij projektligji parashikon disa risi si:

Projektligji propozon zgjerimin e kuadrit ligjor nga kinematografia tradicionale drejt gjithë sektorit audiovizual, duke përfshirë prodhimet digjitale, serialet dhe formatet e reja kreative. Ai parashikon krijimin e Agjencisë Kombëtare të Kinematografisë dhe Audiovizualit (AKKA), ngritjen e Komisionit Shqiptar të Filmit dhe vendosjen e skemës së rimbursimit të shpenzimeve të prodhimit (cash rebate). Gjithashtu, projektligji synon formalizimin dhe zhvillimin e tregut përmes mekanizmave të rinj financiarë, regjistrimit kombëtar të sektorit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Pyetjet

Reagimet që priten janë të hapura dhe nuk parashikohet ngritja e pyetjeve specifike, të cilat kërkojnë përgjigje. Pyetje të mundshme mund të jenë: A pajtoheni me qartësinë e informacionit të paraqitur në dokument dhe çfarë do të propozoni shtesë për të përmirësuar cilësinë e tij? Si i vlerësoni përcaktimet në këtë projektligj.